



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 20, datë 13.01.2020

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“DEPOZITA BREGDETARE ME KAPACITET 3 X 10000 M<sup>3</sup> PËR DEPOZITIM NAFTE  
DHE 1 X 2000 M<sup>3</sup> PËR DEPOZITIM BENZINE”, ME VENDNDODHJE NË PARKUN  
ENERGJITIK DHE INDUSTRIAL PORTO ROMANO, BASHKIA DURRËS,

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Eroil” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Depozita bregdetare me kapacitet 3 x 10000 m<sup>3</sup> për depozitim nafte dhe 1 x 2000 m<sup>3</sup> për depozitim benzine”, me vendndodhje në Parkun Energjitik dhe Industrial Porto Romano, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Eroil” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, datë 29.12.2016, nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIATOTA**

